REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

# KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga P.Q. Dibër dhe mban nga dërguesi nr 128/1 prot datë 01.02.2023 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes( lënda)

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr.hyrës prot 430/1 datë 01.02.2023.

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z

-Znj/Z Sekretarit të Këshillit Bashkiak

-Znj/Z

-Znj/Z

me porosinë:

Administroni praktikën sipas ligjit

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore( përgjigjes,..etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë Sipas afateve

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

Peshkopi, më 01.02.2023

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# PREFEKTI I QARKUT DIBËR

BASHKIA PESHKOPI
Nr. 436/1 Prot
Marrë në 01/02/23

Nr.128/1 prot

Peshkopi më 01.02.2023

Lënda: Për vendimin Nr.01, datë 31.01.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

Drejtuar: Bashkisë Dibër

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut ",neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin Nr.01 datë 31.01.2023 " ***Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin dhjetor 2022, familjeve në nevojë që janë përjashtuar nga sistemi për arsye të pikëzimit ,duke përdorur fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%,i ndryshuar***",konstatova se;

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e kësaj vendimmarrjeje,veprim që kurdoherë është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturës së posaçme të Bashkisë Dibër, që paraqet për miratim projekt akte të kësaj natyre.

Hyrja në fuqi e akteve administrative të kësaj natyre ,bëhet sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Adresa : Bulevardi "Elez ISUFI" Peshkopi, Albania, Tel. 00355 218 2- 2082,Tel 00355 218 2– 2631, E-mail prefekturadiber@gmail.com

PREFEKTURA DIBËR
Nr. 128 Dt. 01.02.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 436 Prot

Peshkopi, më 31.01.2023

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr.01**

**Datë: 31.01.2023**

**"PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN DHJETOR 2022, FAMILJEVE NË NEVOJË QË JANË PËRJASHTUAR NGA SISTEMI PËR ARSYE TË PIKËZIMIT, DUKE PËRDORUR FONDIN E KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, I NDRYSHUAR"**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Afrim Mikli**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

# VENDIM

**Nr.01 Datë31/01/2023**

**"PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN DHJETOR 2022, FAMILJEVE NË NEVOJË QË JANË PËRJASHTUAR NGA SISTEMI PËR ARSYE TË PIKËZIMIT, DUKE PËRDORUR FONDIN E KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, I NDRYSHUAR"**

Në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 dhe VKM 957. Date 04.09.2019. "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të Kreut IV, pika 2 të vendimit nr 955, date 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind", i ndryshuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr 1190/1 prot, datë 23.02.2018 "Për përdorimin e fondit deri në 6%", Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **31.01.2023** me 18 vota pro 0 kundër 0 apstenim ,6% e muajit Dhjetor 2022:

## VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentacionit për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Dhjetor 2022 **502** familjeve në nevojë me fond **2.649.826** të cilat janë aplikuese në sistemin e nd.ekonomike, por nuk janë shpallur fituese.
2. Këto familje janë të përzgjedhura nga njësitë administrative sipas kritereve të përcaktuara me ligj.
3. I bashkangjitet këtij vendimi lista emërore me shumën përkatëse sipas Njësive Administrative.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Sektori i Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Vendimi u shpall më date **31.01.2023**.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

**Kryetar Këshilli**

**Sokol Sava**

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel:0035521822935

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**DREJTORIA EKONOMIKE**
**SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL**

**PROJEKT-VENDIM**

**Nr. 01 datë 17/01/2023**

"PËR PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN DHJETOR 2022, FAMILJEVE NË NEVOJË QË JANË PËRJASHTUAR NGA SISTEMI PËR ARSYE TË PIKËZIMIT, DUKE PËRDORUR FONDIN E KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, I NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 dhe VKM 957. Date 04.09.2019. "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të Kreut IV, pika 2 të vendimit nr 955, date 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind", i ndryshuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr 1190/1 prot, datë 23.02.2018 "Për përdorimin e fondit deri në 6%".

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale pranë Bashkisë Dibër:

**I propozon** Këshillit të Bashkisë Dibër dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Dhjetor 2022, 502 familjeve në nevojë, të cilat janë aplikuese në sistemin e ndihmës ekonomike, por nuk janë shpallur fituese për muajin Dhjetor për arsye të pikëzimit.

Këto familje janë të përzgjedhura nga njësitë administrative sipas kritereve të përcaktuara.

I bashkangjitet këtij Projekt-Vendimi lista emërore me shumën përkatëse sipas Njësive Administrative.

| Përgjegjës i Kujdesit Social | Përgjegjëse Sek. Juridik | Drejtori Ekonomik |
|---|---|---|
| Ardit Hoxha | Elona Lusha | Mensur Shehi |

**KRYETARI I BASHKISË**

**Rahim SPAHIU**